



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 73

Tiranë – E hënë, 10 prill 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.3.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 138, datë 27.2.2013 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2015-2578, datë 16.7.2015 të Gjykatës së Lartë.....	4645
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 30.3.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1307 akti, datë 14.4.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2014-3699 (582), datë 12.11.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4649
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 30.3.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 46, datë 20.1.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-4050, datë 27.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	4655
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 30.3.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	4660
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 32, datë 30.3.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë.....	4663



VENDIM
Nr. 28, datë 30.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese	
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.2.2017, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 94/30 Akti, që i përket:

KËRKUES: Florian Shtalbi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Financave, Dega e Thesarit Gjirokastër

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr. 138, datë 27.2.2013, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 00-2015-2578, datë 16.7.2015, të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000,, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit Gjirokastër, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 65, datë 9.6.2004, ka vendosur, midis të tjerash, deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Trafikim i lëndëve narkotike” mbetur në tentativë, dhe bazuar në nenet 283/a, 2 e 22 të Kodit Penal (KP) e ka

dënuar atë me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të kërkuarit.

2. Gjykata e Apelit Gjirokastër, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e mbrojtësit të kërkuarit, me vendimin nr. 33, datë 4.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal të mësipërm.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 208, datë 31.1.2006, ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i kërkuarit dhe prokurori.

4. Kërkuari, pas arrestimit në datën 19.12.2008, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve penale të dhëna në mungesë, kërkesë e cila u pranua me vendimin nr. 00-2009-655, datë 2.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që vendosi kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Kjo e fundit, me vendimin nr. 254, datë 9.12.2011, vendosi deklarimin të pafajshëm të kërkuarit dhe lirimin e menjëhershëm të tij nga paraburgimi. Ky vendim nuk është kundërshtuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 19.12.2011.

5. Kërkuari, me pretendimin se ka kryer gati 2 vjet burgim të padrejtë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila, me vendimin nr. 700, datë 25.7.2012, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, Degës së Thesarit Gjirokastër, ta kompensojë kërkuarin për burgim të padrejtë në shumën 2.902.000 lekë.

6. Gjykata e Apelit Gjirokastër, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e palës së paditur, Degës së Thesarit Gjirokastër, me vendimin nr. 138, datë 27.2.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2578, datë 16.7.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari në dhomën e këshillimit.

II

8. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 14.11.2016 me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

8.1 Nuk është respektuar *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor* nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata



e Lartë. Konkretisht, Gjykata e Apelit ka interpretuar gabim kriteret e nenit 4 të ligjit nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, nen i cili gjen zbatim për rastin e paraburgimit dhe jo të burgimit. Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk ka vlerësuar faktin se kur është dhënë vendimi nr. 655, datë 9.12.2009 nga Gjykata e Lartë, organet proceduese kanë qenë në dijeni se kërkuesi ndodhej jashtë Shqipërisë në kohën e kryerjes së veprës penale. Po ashtu, fajësia e kërkuesit është bazuar vetëm në thëniet e bashkë të pandehurve të tjerë, duke u dhënë atyre një vlerë të paracaktuar. Vendimi i Gjykatës së Apelit i referohet një vendimi penal i cili ishte shkak për vuajtjen e dënimit në periudhën e parë, por jo më shkak ligjor për mbajtjen e kërkuesit në paraburgim për periudhën 9.12.2009–2.12.2011. Vendimit i mungon koherenca dhe, po ashtu, bie ndesh edhe me vendimin nr. 3/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar mbi shkaqet e mospranimit të rekursit.

8.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj dhe i aksesit në gjykatë*, pasi ndonëse pretendimi për interpretimin e gabuar (sipërfaqësor e deklarativ) të ligjit material është parashtruar edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin në dhomën e këshillimit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve për cenimin nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër të nenit 27 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, nenit 142/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 44 për zhdëmtim nga veprimet e paligjshme të organeve të administratës.

9. **Subjektet e interesuara, Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Gjyrokastër**, kanë prapësuar me shkrim, si vijon:

9.1 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi ai nuk ka parashtruar në ankim faktin e mungesës së tij në Shqipëri kur është kryer vepra penale. Për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet se i ka ezauruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese me kërkesë. Për më tepër, pretendimet e kërkuesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues, sepse argumentet e parashtruara kanë të bëjnë me çmuarjen e provave dhe të fakteve nga gjykatat për të krijuar bindjen e tyre të brendshme për fajësinë apo

pafajësinë e tij.

9.2 Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është i pabazuar, për faktin se Gjykata e Apelit ka arsyetuar se padia nuk duhet të pranohet, pasi kërkuesi mban përgjegjësi për moszbulimin në kohën e duhur të faktit të panjohur dhe për këtë arsye sipas nenit 4 të ligjit nr. 9381/2005 ai duhet të përjashtohet nga e drejta e kompensimit. Po ashtu, Gjykata e Apelit ka arsyetuar se gjatë gjykimit në shkallën e parë kërkuesi është mbrojtur nga mbrojtës i caktuar kryesisht, dhe më pas nëpërmjet prokurës së posaçme ai ka zgjedhur avokatin e tij, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit. Kolegji Administrativ ka dhënë një arsyetim jo të detajuar, por kjo mënyrë arsyetimi, sipas jurisprudencës kushtetuese, nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Për arsyet e mësipërme kërkesa duhet të rrëzohet.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 27, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka



nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ai legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, pretendimet e kërkuesit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të gjykatës së caktuar me ligj dhe të aksesit në gjykatë.

13. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Gjirokastër duke interpretuar gabim ligjin material që i njeh të drejtën atij për kompensim për burgim të padrejtë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Sipas kërkuesit, edhe pse ky pretendim është ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e tij pa u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të, duke cenuar krahas standardit të arsyetimit edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të drejtën e kërkuesit për akses në gjykim.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Administrimi i

mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'iu siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 28, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 21, datë 24.7.2006; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në aspektin kushtetues dhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen. Gjykatat e zakonshme, brenda hapësirës së juridiksionit të tyre, në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të zbatojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese.



17. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsytuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi është shpallur i pafajshëm me vendimin nr. 254, datë 9.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila, referuar vendimit të Gjykatës së Lartë që ka pranuar kërkesën për rishikim, ka verifikuar

nëpërmjet letërporosisë dërguar autoriteteve kompetente greke se i pandehuri ka qenë i shtruar në Spitalin Universitar në Janinë në datat 1-6 korrik 2002 dhe nga kopjet e fletëve të pasaportës së përdorur prej tij se ai ishte pajisur me vizë për në shtetin grek. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka arritur në përfundimin se i pandehuri nuk i ka kryer veprimet kriminale dhe se nuk është fajtor për veprën për të cilën akuzohet. Për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë e ka deklaruar atë të pafajshëm. Gjatë procesit gjyqësor për kompensimin e dënimit të padrejtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, bazuar edhe në vendimin e mësipërm, i ka njohur kërkuetit të drejtën për kompensim për paraburgim e burgim të padrejtë, duke argumentuar se nuk është provuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën dyshohej dhe ka ndërmarrë veprime që kanë shkaktuar tërësisht ose pjesërisht marrjen e një vendimi të gabuar për kufizimin e lirisë personale ose moszbulimin në kohë të së vërtetës lidhur me ngjarjen në fjalë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në ndryshim nga qëndrimi i mësipërm, ka arsytuar se paditësi është burgosur dy vjet pas përfundimit të gjykimit të procedimit penal në të tria shkallët e gjyqësorit dhe se vetëm në kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë ai ka ngritur pretendimin se nuk ka qenë në Shqipëri në kohën e krimit. Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka arritur në përfundimin se paditësi ka përgjegjësi të plotë për moszbulimin në kohë të faktit të panjohur. Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit në dhomën e këshillimit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

20. Gjykata rithekson se edhe pse interpretimi i ligjit material e procedural dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, në një shtet të së drejtës roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i pazëvendësueshëm. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat që të marrë një rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr.*



24, datë 25.4.2016; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Nga kjo pikëpamje, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës në të tilla raste kërkuesit duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016, nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në vështrim të sa më sipër, bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi, dhe po ashtu, nisur nga dy qëndrimet e kundërta të gjykatave të zakonshme mbi kuptimin e dispozitave të ligjit nr. 9381, datë 28.4.2005, "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", Gjykata çmon se qëndrimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor sa kohë ngre dyshime serioze për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së aksesit në gjykatë dhe së drejtës për ankim substancial.

22. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-2578, datë 16.7.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 29, datë 30.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	" "
Vitore Tusha	anëtare e	" "
Fatmir Hoxha	anëtar i	" "
Gani Dizdari	anëtar i	" "
Fatos Lulo	anëtar i	" "
Besnik Imeraj	anëtar i	" "

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.2.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 92/28 Akti, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Kolonja, Konstandin Kolonja, Linde Ulrike Schiedel, Sabire Kolonja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ambasada e Republikës së Turqisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Alma Zadeja (Radovicka), Gëzim Radovicka, Gazmend Radovicka, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1307 akti, datë 14.4.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2014-3699 (582), datë 12.11.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 116, 122, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 39, 60 dhe 61 të Kodit të Procedurës Civile; nenet 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18.4.1961; nenet 7 dhe 13 të Konventës për Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe të Pronave të tyre nga Asambleja e



Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 2004; nenet 27 dhe 28, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Punëve të Jashtme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Alma Zadeja (Radovicka), Gëzim Radovicka dhe Gazmend Radovicka, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit Aleksandër Kolonja, Konstandin Kolonja, Linde Ulrike Schiedel dhe Sabira Kolonja janë trashëgimtarë ligjorë të ish-pronarit Sh.K., i cili me kontratën e shitblerjes të datës 19.11.1940 ka blerë nga shtetasi N.R. një sipërfaqe toke prej 2000 m².

2. Me vendimin nr. 564, datë 17.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë Bashkisë Tiranë ka vendosur njohjen pronar dhe kthimin e një sipërfaqeje truallit prej 26.757 m² ish-pronarit N.R., trashëgimtarët e të cilit (subjektet e interesuara Radovicka) me kontratën e datës 2.6.2011 i kanë shitur Ambasadës së Republikës së Turqisë një sipërfaqe toke prej 6.780 m².

3. Kërkuësit, duke pretenduar se në sipërfaqen e kthyer me vendim të KKKP-së, një pjesë e së cilës i është shitur më pas Ambasadës së Republikës së Turqisë, është përfshirë padrejtësisht edhe sipërfaqja prej 2000 m², në pronësi të trashëgimlënësit të tyre, i janë drejtuar gjykatës me padë me objekt anulimin pjesërisht të vendimit nr. 564, datë 17.12.1995 të KKKP-së Tiranë për sa i përket sipërfaqes së tokës 2000 m²; detyrimin e palëve të paditura t'i njohin ata pronarë; konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme të kontratës të shitjes të datës 2.6.2011; detyrimin e së paditurës Ambada e Republikës së Turqisë që të lirojë dhe t'u dorëzojë sipërfaqen e truallit prej 2000 m²; urdhërimin e ZRPP-së që

të fshijë regjistrimin e bërë në emër të të paditurve dhe të regjistrojë pronën në emër të kërkuësve.

4. Me vendimin nr. 1307 akti, datë 14.4.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mungesën e juridiksionit gjyqësor mbi palën e paditur Ambada e Republikës së Turqisë, bazuar në nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenin 31 të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, duke vlerësuar se ky subjekt gëzon mbrojtje nëpërmjet imunitetit që ofron Konventa dhe se vetë ambada, me anë të notës verbale të datës 18.2.2013, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka refuzuar marrjen e fletëthirrjes së gjykatës, duke mos pranuar vullnetarisht për t'iu nënshtruar juridiksionit gjyqësor. Po ashtu, gjykata ka pranuar edhe kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme për të marrë pjesë në gjykim si person i tretë. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë.

5. Me vendimin nr. 00-2014-3699 (582), datë 12.11.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në përfundim të gjykimit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

6. Në lidhje me themelin e çështjes rezulton se me vendimin nr. 5847, datë 13.7.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Anulimin e pjeshëm të vendimit nr. 564, datë 17.12.1995 të KKKP-së Tiranë vetëm për sipërfaqen 2000 m²... Detyrimin e të paditurve Alma Zadeja (Radovicka), Gëzim Radovicka dhe Gazmend Radovicka të njohin pronarë paditësit Aleksandër Kolonja, Konstandin Kolonja, Linde Ulrike Schiedel dhe Sabira Kolonja, për sipërfaqen 2000 m²...”. Për sa u takon pretendimeve të tjera të ngritura nga kërkuësit në kërkesëpadi, konkretisht ato që lidhen me konstatimin e pavlefshmërisë së pjeshme të kontratës së shitjes dhe detyrimin e Ambasadës së Republikës së Turqisë për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së truallit, në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar se në lidhje me këto kërkime ajo është shprehur më parë në vendimin e ndërmjetëm të datës 14.4.2014 dhe se nuk mund të gjykojë asnjë lloj kërkimi që i drejtohet këtij subjekti, Ambasadës së Republikës së Turqisë.



7. Kërkuesit i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për plotësim vendimi, me pretendimin se gjykata nuk është shprehur në dispozitiv për të gjitha kërkimet e palës paditëse, konkretisht ato që lidhen me të paditurën Ambasada e Republikës së Turqisë.

8. Me vendimin nr. 758 akti, datë 19.11.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë.

II

9. **Kërkuesit Aleksandër Kolonja etj.**, i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Interpretimi i Kolegjit Civil në lidhje me zbatimin e neneve 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës dhe, për rrjedhojë, përjashtimi i Ambasadës së Republikës së Turqisë nga procesi gjyqësor është jo korrekt dhe jo në përputhje me standardet e mbajtura në raste të tjera. Ky qëndrim ka krijuar një situatë paradoksale, ku pronarët realë të pasurisë nuk mund të gëzojnë të drejtën e pronësisë të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, kjo i privon kërkuesit edhe nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, pasi nuk lejon marrjen e masës së sigurimit të padisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

9.2 Në rastin konkret jemi përpara rastit përjashtimor të juridiksionit të gjykatave shqiptare, pasi në kontratën e shitblerjes të lidhur mes palëve të paditura është pranuar nga ana e Ambasadës së Republikës së Turqisë juridiksioni i gjykatave shqiptare për zbatimin e kësaj kontrate, në kuptim të neneve 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës, dhe ajo ka hequr dorë vullnetarisht nga imuniteti.

9.3 Sipas nenit 32/3 të Konventës së Vjenës, në rast se përfaqësuesi diplomatik futet në një proces gjyqësor, çka parashikohet në pikën 9 të kontratës të lidhur mes palëve të paditura, ai nuk mund të gëzojë imunitet në lidhje me çdo kundërpadi që lidhet me padinë kryesore. Sipas kontratës, ambasada ka pranuar juridiksionin shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të dalin gjatë zbatimit të saj dhe nuk e ka lidhur këtë me subjektin kontraktor, por me

mosmarrëveshjet mes palëve. Nga konteksti i Konventës së Vjenës kufizimet për juridiksionin lidhen me objektin e marrëdhënies kontraktuale dhe jo me subjektin kontraktor. Është nonsens që ky subjekt pranon juridiksionin për shitësin jolegjitim, familjen Radovicka, dhe nuk e pranon atë për pronarin legjitim, familjen Kolonja. Për rrjedhojë, neni 9 i kontratës duhet konsideruar si pranim i juridiksionit të gjykatave shqiptare. Ky qëndrim mbështetet edhe në vendimin unifikues nr. 8, datë 10.6.2011 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit edhe pse asnjë nga marrëveshjet ndërkombëtare nuk përcakton formalisht aktin e heqjes dorë nga imuniteti, vetëm akti ku vullneti i subjektit është shprehur qartë e fut çështjen në juridiksionin e gjykatave shqiptare.

9.4 Po ashtu, sipas nenit 31/a të Konventës së Vjenës agjenti diplomatik gëzon imunitet përveçse kur bëhet fjalë për një veprim real lidhur me një pasuri të paluajtshme private që ndodhet në territorin e shtetit pritës, përveçse kur ai e posedon për llogari të shtetit akreditues për qëllimet e misionit. Pasuria në fjalë është e regjistruar në ZRPP-në Tiranë në emër të Ambasadës së Republikës së Turqisë, por nuk është vendi ku agjenti diplomatik ushtron aktivitetin e tij. Sipas faqes zyrtare të ambasadës ajo e ushtron aktivitetin në një godinë të marrë me qira, kurse sipas faqes zyrtare të Bashkisë së Tiranës sipërfaqja objekt konflikti gjyqësor figuron pjesë e Parkut të Madh të Tiranës, për rrjedhojë kuadri ligjor nuk krijon hapësirë për t'u pajisur me leje ndërtimi.

10. **Subjekti i interesuar, Ambasada e Republikës së Turqisë**, ka informuar Gjykatën se për shkak të statusit të saj diplomatik nuk ka marrë pjesë dhe nuk është shprehur në asnjë nga proceset gjyqësore dhe se këtë përfaqësim e ka marrë përsipër **Ministria e Punëve të Jashtme**. Kjo e fundit, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

10.1 Në rastin konkret qëndrojnë përballë njëra-tjetrës dy të drejta, ajo e individit dhe ajo e interesit të përgjithshëm. GJEDNJ-ja ka theksuar se e drejta e individit nuk është një e drejtë absolute, por ajo mund të kufizohet me ligj dhe në rast se cenon interesin e përgjithshëm.

10.2 Konflikti real në çështjen objekt shqyrtimi është ai mes dy palëve të së drejtës



civile, i cili rezulton të jetë ende në shqyrtim nga gjykatat e faktit, pra i pazgjidhur gjyqësisht. Pretendimi se në rast të mospranimit të kërkesës ekziston rreziku që të cenohet e drejta e pronësisë, e cila nuk është sanksionuar me vendim të formës së prerë, do të krijonte një amull në sistemin gjyqësor dhe do të binte ndesh me qëndrimin e kësaj Gjykate për sa i takon vlerësimin të ligjshmërisë së procesit gjyqësor në gjykatat e zakonshme, të cilat nuk janë shprehur me vendim për këtë rrezik të supozuar.

10.3 Pranimi i juridiksionit të gjykatave shqiptare në nenin 9 të kontratës nga palët nënshkruese të saj, i shtrin efektet vetëm ndërmjet këtyre palëve dhe nuk mund të dalë tej vullnetit të parashikuar shprehimisht dhe të pranuar verbalisht prej tyre.

10.4 Referimi i kërkesve në vendimin unifikues nr. 8/2011 është i gabuar, pasi me këtë vendim është njësuar praktika gjyqësore në marrëdhëniet e punës. Sipas vendimit unifikues heqja dorë nga imuniteti kërkon domosdoshmërisht qenien palë të këtij vullneti. Në rastin konkret, Ambasada e Republikës së Turqisë nuk është palë në marrëdhënien juridike kontratë shitblerje me familjen Kolonja, por me familjen Radovicka dhe vetëm me këtë palë ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare. Po ashtu, pala turke nuk ka hequr dorë nga imuniteti, por ka kërkuar përfitimin prej tij dhe prej privilegjeve të njohura nga Konventa e Vjenës.

10.5 Destinacioni i kësaj pasurie është i qartë, pasi përpara blerjes së pasurisë agjenti diplomatik ka marrë pëlqimin dhe ka njoftuar palën shqiptare, në rastin konkret Ministrinë e Punëve të Jashtme, se kjo pronë do të blihet me qëllim përdorimin e saj për ndërtimin e godinës që do të shërbejë si seli e ambasadës. Në momentin që prona është transkriptuar dhe është certifikuar ky transaksion nëpërmjet lëshimit të certifikatës së pronësisë, ajo ka marrë status të veçantë të mbrojtur nga Konventa.

11. Subjektet e interesuara, Alma Zadeja (Radovicka), Gëzim Radovicka dhe Gazmend Radovicka, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar:

11.1 Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese janë paraqitur të gjitha shkaqet e

ngritura në rekurs, të cilave Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje. Po ashtu, në kërkesë nuk paraqitet asnjë shkelje ligjore dhe kushtetuese e procesit të zhvilluar në atë gjykatë.

11.2 Gjykata e Lartë ka arsyetuar në vendimin e saj se përse në rastin në fjalë nuk kemi shprehje të vullnetit për heqjen dorë nga imuniteti. Megjithatë, në nenin 9 të kontratës pranohet juridiksioni shqiptar për mosmarrëveshjet që lindin nga kontrata e shitblerjes, e cila është zbatuar tërësisht, pasi palët i kanë shlyer detyrimet ndaj njëra-tjetrës dhe prona është regjistruar në ZVRPP.

11.3 Referimi në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë është i gabuar, pasi ai ka pasur për objekt një marrëdhënie pune.

11.4 Pretendimi i kërkesve për humbjen e së drejtës për të gëzuar pronën e tyre nuk është i drejtë. Subjektet e interesuara në asnjë moment gjatë gjykimit nuk e kanë kundërshtuar faktin e njohjes së pronësisë të familjes Kolonja për sipërfaqen 2000 m² dhe kanë ofruar jashtëqyqësisht dhe në gjykim zgjidhjen me pajtim, duke dhënë disa variante për kërkuessit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesve

12. Gjykata vlerëson se kërkuessit legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata vëren se neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individë mund t’i drejtohet asaj për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individë duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuessi duhet t’i



shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohet të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se objekt kundërshtimi para saj është bërë një vendim i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur përfundimisht nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar lidhur me palën e paditur në proces Ambasada e Republikës së Turqisë. Në kushtet kur ky vendim është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes, kërkesit nuk kanë mjet tjetër ligjor për të goditur këtë vendim. Për rrjedhojë, kërkesit legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

16. Sipas kërkesve, interpretimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin e neneve 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës dhe, për rrjedhojë, përjashtimi i Ambasadës së Republikës së Turqisë nga procesi gjyqësor u ka cenuar atyre të drejtën e pronës private dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas tyre, ambasada e ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në kontratën e shitblerjes të lidhur mes palëve të paditura, dhe në këtë mënyrë ka hequr dorë vullnetarisht nga imuniteti. Po ashtu, po në kuptim të Konventës së Vjenës, pasuria objekt konflikti edhe pse është e regjistruar në ZRPP-në Tiranë në emër të Ambasadës së Republikës së

Turqisë, nuk rezulton të jetë vendi ku agjenti diplomatik ushtron aktivitetin e tij.

17. Bazuar në parimin *jura novit curia* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të pretendimeve të kërkuësve, ato duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

18. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e



veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas GJEDNJ-së do të ishte e pakonceptueshme që neni 6/1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojë në radhë të parë atë që në fakt bën të mundur përfitimin e garancive të tilla, që është aksesit në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore. Pra, duke bërë një interpretim të të "drejtave efektive", GJEDNJ-ja ka përcaktuar se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor. E drejta e aksesit është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të Konventës. Kështu, neni 6/1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata ka theksuar se në aspektin kushtetues dhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm brenda hapësirës së juridiksionit të tyre dhe në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të zbatojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata rithekson se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor.

Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke vlerësuar respektimin e standardeve të mësipërme në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se me vendimin nr. 1307 akti, datë 14.4.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mungesën e juridiksionit gjyqësor mbi palën e paditur Ambasada e Republikës së Turqisë, bazuar në nenin 39 të KPC-së dhe nenin 31 të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, duke vlerësuar se ky subjekt gëzon mbrojtje nëpërmjet imunitetit që ofron Konventa dhe se nuk ka pranuar vullnetarisht për t'iu nënshtruar juridiksionit gjyqësor. Ky vendim u kundërshtua nga kërkuesit në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2014-3699 (582), datë 12.11.2014 të Kolegji Civil, vendosi lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, Gjykata vëren se për sa i takon themelit të çështjes, pra kërkimeve të ngritura në kërkesëpadi, me vendimin nr. 5847, datë 13.7.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: "*Pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Anulimin e pjeshëm të vendimit nr. 564, datë 17.12.1995 të KKKP-së Tiranë vetëm për sipërfaqen 2000 m²... Detyrimin e të paditurve Alma Zadeja (Radovicka), Gëzim Radovicka dhe Gazmend Radovicka të njohin pronarë paditësit Aleksandër Kolonja, Konstandin Kolonja, Linde Ulrike Schiedel dhe Sabira Kolonja, për sipërfaqen 2000 m²...*". Po ashtu, sipas parashtrimeve të palëve dhe materialeve bashkëlidhur kërkesës, rezulton se ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit dhe çështja është ende në shqyrtim në atë gjykatë.

23. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se për sa kohë çështja e themelit është ende në shqyrtim në gjykatat e faktit dhe nuk ka një vendim përfundimtar për sa u takon kërkimeve të ngritura në kërkesëpadi, kërkuesit kanë të



drejtën dhe mundësinë të përdorin mbrojtjen juridiksionale për sa u takon pretendimeve të tyre në lidhje me të drejtën kushtetuese të pronës private, të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, dhe të marrin një përgjigje përfundimtare nga gjykata e faktit në lidhje me këto pretendime, në kuptim të së drejtës së aksesit në gjykatë, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar është i pabazuar dhe kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo. Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 30, datë 30.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 9.2.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 91/27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Avni Koboçi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 46, datë 20.1.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-4050, datë 27.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europene për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30 dhe 81/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuar, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 273, datë 23.12.2005, ish-Policia Ndërtimore Dega Tiranë ka vendosur prishjen e një ndërtese 4-katëshe, e ndodhur në rrugën “Ali Demi”, Tiranë, sepse ishte ndërtuar pa leje ndërtimi. Pas ankimit në rrugë administrative, Drejtori i Policisë së Ndërtimit, me vendimin nr. 313, datë 12.6.2006, ka vendosur të ndryshojë vendimin e mësipërm të Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë, duke pranuar pjesërisht ankimin për pjesën e ndërtimit për të cilën disponohet vërtetim pronësie dhe ka lënë në fuqi këtë vendim për shtesën 3 kate të ndërtuar pa leje ndërtimi. Pas verifikimit në detaje të dokumentacionit, Policia Ndërtimore ka arritur në përfundimin se i gjithë ndërtimi është pa leje dhe e ka prishur atë.

2. Kërkuar Avni Koboçi, duke pretenduar se është pronar i katit përdhe të ndërtesës katërkatëshe, me sipërfaqe 65 m², pasuri e regjistruar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar



(INUK) dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik (INU) të Bashkisë Tiranë, që t'i shpërblejnë dëmin e shkaktuar nga prishja e objektit.

3. Me vendimin nr. 9664, datë 10.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë të paditësit Avni Koboçi. Detyrimin e të paditurit INUK që të dëmshpërblejë palën paditëse Avni Koboçi në vlerën 18.000.000 lekë që përfaqëson vlerën e ndërtimit njëkatësh që paditësi ka pasur të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, të prishur nga pala e paditur. Rrëzimin e padisë për detyrimin e palës së paditur INU Bashkia Tiranë.”*

4. Me vendimin nr. 46, datë 20.1.2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 9664, datë 10.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke rrëzuar padinë e paditësit Avni Koboçi.”*

5. Në kushtet kur në gjykimin në apel kërkuesi ka qenë në mungesë, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Me vendimin nr. 251, datë 5.4.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës. Rivendosjen e së drejtës së kërkuetit Avni Koboçi për të paraqitur ankim (rekurs) në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit nr. 46, datë 20.1.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e sotme.”*

6. Me vendimin nr. 00-2014-4050, datë 27.11.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, *“Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*.

II

7. **Kërkuesi Avni Koboçi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

7.1 Është cenuar e drejta e aksesit, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të nenit 62/c të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur dy vendimet e gjykatave më të ulëta janë me zgjidhje ligjore të ndryshme, duke u bazuar edhe në trajtimin e provave në mënyra të ndryshme.

7.2 Kolegji Administrativ ka përdorur një arsyetim ndryshe edhe nga vetë rrethanat e çështjes që ka parashtruar në vendimin e tij, nga ku rezulton se kërkuesi e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme me anë të kontratës së shitblerjes. Ai ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të mbajtur nga Kolegji Civil në një çështje tjetër që i referohet të njëjtit objekt, ku është pranuar padia e shoqërisë “Intersig” sh.a. dhe N.H. me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për prishjen e tri kateve të tjera të ndërtuara sipër ndërtimit të kërkuetit me aktin administrativ nr. 263, datë 23.12.2005 të Degës së Policisë së Ndërtimit Tiranë.

7.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi Kolegji Administrativ duhej t'u jepte mundësi të barabarta palëve në proces, për shkak të natyrës me rëndësi të çështjes, humbjes së një të drejte pronësie nga vendimi i Gjykatës së Apelit i gjykuar pa praninë e kërkuetit dhe të mbrojtësit të tij. Barazia e armëve do të ndikonte pozitivisht në dhënien e një vendimi të drejtë, sepse kanë prevaluar në vlerësimin e gjykatave pretendimet e njëres palë, në mënyrë të njëanshme. Pabarazia nëpërmjet mospranisë në proces i ka ardhur kërkuetit jo si shkak i neglizhencës së tij, por për shkak të moskryerjes së detyrimeve ligjore nga avokati i tij, çka përbën shkak që Kolegji Administrativ të cenonte vendimin e Gjykatës së Apelit.

8. **Subjekti i interesuar, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**, ka prapësuar me shkrim para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, sa më poshtë vijon:

8.1 Kërkuesi ose mbrojtësi i tij kanë neglizhuar detyrimet ligjore dhe nuk kanë ushtruar recurs brenda afatit ligjor. Gjykata e Apelit në interpretim të gabuar të nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) ka vendosur për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

8.2 Referuar vendimeve të Gjykatës së Lartë, si dhe dispozitave të KPC-së vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ nuk përbën cenim të të drejtave kushtetuese të kërkuetit. Kjo Gjykatë ka zhvilluar një proces të rregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

9. Gjykata vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Gjykata vëren se kërkuessi, dhe pse në objekt të kërkesës ka kundërshtuar edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, ai nuk ka paraqitur asnjë argument në mbështetje të pretendimit për jokushtetutshmërinë e procesit të zhvilluar në atë gjykatë. Kurse në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuessi legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

10. Sipas kërkuessit është cenuar e drejta e aksesit në gjykim, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të nenit 62/c të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur vendimet e gjykatave më të ulëta kanë dhënë zgjidhje ligjore të ndryshme. Kolegji Administrativ ka përdorur një arsytim ndryshe edhe nga vetë rrethanat e çështjes të parashtruara në vendimin e tij, nga ku rezulton se kërkuessi e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme, me anë të kontratës së shitblerjes. Sipas kërkuessit, ky Kolegj ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të mbajtur nga Kolegji Civil në një çështje tjetër që i referohet të njëjtit objekt (godinë), ku është pranuar padia me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për prishjen e tri kateve të tjera të ndërtuara sipër pronës së kërkuessit.

11. Në jurisprudencën kushtetuese çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se

kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave



të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 42, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, vëren se në rastin konkret gjykata të niveleve të ndryshme i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme konfliktit gjyqësor në fjalë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar: “Pala e paditur nuk paraqiti para gjykatës prova që të vërtetojnë se Dega e Policisë së Ndërtimit Tiranë në prishjen e objektit ka verifikuar faktin e kundërvajtjes administrative të ndërtimit pa leje të katit të parë nga pala paditëse. Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendoi pala e paditur në gjykim, nga akti i ekspertimit u vërtetua se objekti i prishur është i njëjti objekt që pala paditëse ka regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe që i korrespondon vërtetimit nga dokumenti hipotekor i administruar në seancë gjyqësore”, duke vendosur në përfundim të gjykimit pranimin e kërkesëpadisë. Në ndryshim nga sa më sipër, Gjykata e Apelit ka rrëzuar kërkesëpadinë, duke vlerësuar: “Provohet

plotësisht se ndërtimi ka qenë me konstruksion të lehtë dhe nuk ka asnjë lloj projekti të paraqitur për të, dhe i gjithë ndërtimi i kryer nga paditësi nga themelet është ndërtim i ri pa lejen e organeve kompetente. Në procesverbalin e inspektorit të ndërtimit të konstatimit të ndërtimit pa leje është materializuar fakti se godina katërkatëshe ka qenë e tëra me konstruksion beton arme dhe mur tulle.”.

15. Gjykata vëren se edhe pse në rekurs kërkuesi ka pretenduar se objekti në pronësi të tij, kati i parë i një godine katërkatëshe, është blerë me kontratë të rregullt dhe është regjistruar edhe në regjistrin e pasurive të paluajtshme, dhe se prishja është bërë në mënyrë arbitrare, duke i shkaktuar dëm atij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se Gjykata e Apelit ka respektuar ligjin material duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë atë.

16. Gjithashtu, Gjykata vëren se në lidhje me tri katet e tjera të këtij objekti, të ndërtuara mbi pronën e kërkuetit, të cilat kanë qenë në pronësi të shoqërisë “Intersig” sh.a. dhe shtetases N.H., gjykatat e faktit kanë vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga prishja e tyre. Kundër këtyre vendimeve gjyqësore kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë INUK-u dhe Avokatura e Shtetit, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2015-4020, datë 4.12.2015, ka vendosur mospranimin e tyre. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se në lidhje me të njëjtin ndërtim dhe të njëjtin konflikt gjyqësor, gjykatat kanë dhënë zgjidhje të ndryshme për palët në proces, duke mbajtur standarde të ndryshme për çështje të njëjta. Pavarësisht se në rastin konkret vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i sipërcituar, është më i vonshëm në kohë se sa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Gjykata duhet të theksojë se barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (shih vendimin nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Gjykata vlerëson se nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe



bazuar jo vetëm në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë, por edhe se gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë ngre dyshime edhe në lidhje me respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

19. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ duhej t'u jepte mundësi të barabarta palëve në proces, për shkak të natyrës me rëndësi të çështjes, për më tepër në kushtet kur gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë pa praninë e kërkuesit dhe të mbrojtësit të tij. Sipas kërkuesit, mosprania e tij në proces ka ardhur për shkak të moskryerjes së detyrimeve ligjore nga avokati,

çka përbën shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit.

20. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërit palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se meqenëse gjykimi në Gjykatën e Apelit është bërë në mungesë të kërkuesit, ky i fundit është i është drejtuar kësaj gjykate për rivendosjen në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, kërkesë që i është pranuar me vendimin nr. 251, datë 5.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Mbi këtë bazë kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i cili është legjislacioni i ri procedural i zbatueshëm në këto lloj gjykimesh, ka parashikuar, mes të tjerash, edhe procedurën e gjykimit të këtyre çështjeve. Sipas nenit 61 të ligjit shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes



në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

22. Gjykata ka theksuar dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012 për gjykimin e çështjeve administrative. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk rezulton të jetë vënë në një situatë jo të favorshme në krahasim me palën tjetër në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Ai ka pasur mundësinë të paraqesë në rekurs të gjitha argumentet e tij ndaj vendimit të kundërshtuar të gjykatës më të ulët, ka marrë dijeni për procesin e zhvilluar në atë gjykatë, duke pasur edhe mundësinë të mbrohet kundër pretendimeve të palës kundërshtare në gjykim. Për rrjedhojë, vetëm fakti i shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të mbështetur pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në gjykimin e zhvilluar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë janë të bazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-4050, datë 27.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 31, datë 30.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.2.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 3 Akti, që u përket palëve:



KËRKUESE: Zhaneta Hoxha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Qarkut Tiranë, Shoqëria Përmbartimore “Bailiff Services Albania” sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, pretendimet e subjektit të interesuar, shoqërisë përmbartimore “Bailiff Service Albania”, që kërkuan pranimin e kërkesës dhe të subjektit të interesuar Këshilli i Qarkut Tiranë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja Zhaneta Hoxha prej vitit 2001 deri në datën 31.12.2007 ka punuar në Sektorin e Financës në Këshillin e Qarkut Tiranë. Me shkresën nr. 3, datë 31.12.2007 të Sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë është liruar nga detyra. Mbi ankimin e kërkuases, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 56, datë 20.2.2008, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 3, datë 31.12.2007 të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Qarkut Tiranë, kthimin në pozicionin e punës si drejtoresh e Drejtorisë së Financës dhe Administrimit Financiar dhe detyrimin për të bërë pagesën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e zbatimit të urdhrit.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 91, datë 9.7.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 56, datë 20.2.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil.

3. Mbi rekursin e Këshillit të Qarkut Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012 376, datë 6.9.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 91, datë 9.7.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit. Gjykata, me

vendimin nr. 11327 akti, datë 27.11.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 56, datë 20.2.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil lënë në fuqi me vendimin nr. 91, datë 9.7.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

5. *Kërkuesja Zhaneta Hoxha* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

6. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Qarkut Tiranë*, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

6.1 Detyrimi monetar i vendimit objekt kërkesë nuk është i përcaktuar qartë, si rrjedhim nuk mund të zgjasë ekzekutimi pafundësisht për shkak të mosekzistencës së pozicionit të punës. Këshilli i Qarkut Tiranë ka marrë masa në vitin 2015 duke likuiduar shumën 53.263 lekë dhe shumën 592.520 lekësh. Ka mbetur për t'u likuiduar shuma prej 72.705 lekë për vitin 2016.

6.2 Këshilli i Qarkut Tiranë në vitin 2013 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 583, datë 20.12.2016, ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

7. *Shoqëria përmbartimore “Bailiff Service Albania”* ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si më poshtë:

7.1 Shoqëria përmbartimore ka kryer të gjitha veprimet procedurale të parashikuara nga ligji për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ka dërguar shkresa për lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit e me pas ka vijuar me procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm. Në kushtet kur pala debitore nuk ka marrë masa ka vijuar me vendosjen e masës së sekuestros në llogarinë pranë Degës së Thesarit deri në vendosjen e masës së gjobës. Vetëm në vitin 2015 pala debitore ka marrë masa për likuidimin pjesërisht të detyrimit në shumën totale 645.748 lekë. Në vijim shoqëria përmbartimore me shkresën nr.



3295 prot., 1569 regj, datë 1.10.2015 e ka njoftuar palën debitore për të marrë masa për shlyerjen e detyrimit.

7.2 Lidhur me detyrimin për të rikthyer kërkesën në vendin e mëparshëm të punës, Këshilli i Qarkut, me shkresën nr. 1245/1 prot., datë 10.6.2016 ka sqaruar se kthimi në detyrë nuk mund të bëhet për shkak të suprimimit të vendit të punës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

8. Gjykata vëren se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 31 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Për legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një së drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend i së drejtës të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 1, datë 21.1.2016, nr. 6, datë 23.2.2016; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkesit. Për

vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Ndërsa për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këtë drejtim është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse shoqëria përmbartimore “Bailiff Services Albania” sh.p.k. ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezulton se shoqëria përmbartimore ka dërguar shkresën me nr. 3033/1 prot., datë 21.12.2012, lajmërim për ekzekutim vullnetar. Nga Këshilli i Qarkut Tiranë nuk është kryer asnjë veprim, si dhe nuk është kthyer përgjigje. Në datën 27.3.2013, me shkresën nr. 833/1 prot., shoqëria përmbartimore ka vendosur pushimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor në bazë të nenit 616/b të KPC-së, pasi kërkesja ka hequr dorë nga ekzekutimi.

12. Në datën 1.7.2014 kërkesja ka riparuar kërkesën për ekzekutimin e vendimit. Me shkresën nr. 2145 prot., datë 1.7.2014 i është dërguar Këshillit të Qarkut Tiranë njoftim për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Njoftimet janë përsëritur në vazhdimësi me shkresat nr. 3553 prot., datë 27.10.2014 dhe nr. 3721/1 prot., datë 10.11.2014 për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Me shkresat nr. 3721 prot., datë 20.11.2014 dhe nr. 843 prot., datë 9.3.2015 është urdhëruar Dega e Thesarit Tiranë të kryejë vendosjen e sekuestros konservative në llogari të thesarit. Me shkresën nr. 1509 prot., datë 13.5.2015 është vendosur gjobitja e z. T.M., në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë. Me shkresën nr. 4074 prot., datë 22.12.2015, duke qenë se nuk është kryer asnjë veprim, shoqëria përmbartimore ka njoftuar përsëri



Këshillin e Qarkut Tiranë për të kryer veprimet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

13. Nga ana tjetër, Dega e Thesarit Tiranë, me shkresat nr. 534/1 prot., datë 26.1.2016 ka vënë në dijeni Këshillin e Qarkut Tiranë për vënien e sekuestros konservative dhe marrjen e hapave për ekzekutimin e vendimit. Me shkresën nr. 534/2 prot., datë 3.2.2016 ajo ka urdhëruar bllokimin e fondeve buxhetore të Këshillit të Qarkut në favor të kërkueses në vlerën e pashlyer të detyrimit 5,279,539 63 lekë. Me shkresën nr. 534/4 prot., datë 15.2.2016, Dega e Thesarit Tiranë ka njoftuar përsëri debitorin për ekzekutimin e vendimit dhe marrjen e masave për zbatimin e udhëzimit nr. 1, datë 4.6.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjste të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” të Këshillit të Ministrave.

14. Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. Zh-15/6 prot., datë 8.8.2016 drejtuar kërkueses, sqaron se kthimi i kërkueses në detyrë është i pamundur, pasi sipas strukturës për vitin 2016 personeli nuk mund të jetë më shumë se 10 persona. Lidhur me detyrimin monetar duke qenë se detyrimi nuk është i përcaktuar, është hartuar grafiku në vlerën 720 000 lekë pagesë për periudhën 1-vjeçare. Vlera është likuiduar në shumën 645.783 lekë dhe pjesa e mbetur në shumën 72.705 lekë për vitin 2016 do të likuidohet në vazhdim. Nga materialet e ndodhura në dosje rezulton se subjekti i interesuar, Këshilli i Qarkut Tiranë, me pretendimin se është vënë në dijeni të rrethanave të reja, të cilat nuk dihen gjatë shqyrtimit të çështjes në datën 29.1.2013, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 583, datë 20.12.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 376, datë 6.9.2012 të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit nr. 91, datë 9.7.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

15. Gjykata, pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, vëren se pretendimi i ngritur nga kërkuësja nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve prej 5 anëtarësh të kërkuar nga ligji. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Gjatë shqyrtimit të çështjes 4 gjyqtarë votuan për rrëzimin e kërkesës dhe 3 për pranimin e saj¹. Nisur nga ky fakt, bazuar në nenin 73 të këtij ligji, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 32, datë 30.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 9.3.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë

¹ Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha dhe Fatos Lulo. Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Vladimir Kristo, Gani Dizdari dhe Besnik Imeraj.



dokumentesh, çështjen nr. 5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Albert Musteqja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Lufti Hasani, Përparime Bazaj, Admir Bazaj, Sonila Bazaj, Ornela Bazaj

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Shpërblimi i dëmit pasuror e jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 44, 131/f, 134/1/i dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 7/1/2/6 i ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në bazë të vendimit nr. 24499/1, datë 18.6.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuari është administrator i shoqërisë “Luval” sh.p.k., kjo e fundit e regjistruar me vendimin nr. 24499, datë 9.10.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Për shkak të vështirësive financiare të shoqërisë “Luval” sh.p.k., kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar hapjen e procedurës së falimentimit të kësaj shoqërie.

3. Me vendimin nr. 12508, datë 18.12.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti i interesuar Lufti Hasani. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 248, datë 29.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12508, datë 18.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-2587, datë 30.9.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Lufti Hasani, pasi nuk përmban kriteret e përcaktuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

6. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm (neni 42/2 i Kushtetutës) gjatë gjithë shkallëve të gjykimit. Ai pretendon se, edhe pse ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (në vijim ligji nr. 8901/2002) parashikon afate të përcaktuara për këtë lloj gjykimi, ato nuk janë respektuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Kjo rrethanë sipas kërkuarit ka ndikuar në mosekzekutimin e vendimit nr. 12508, datë 18.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, arsye për të cilën ai kërkon shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për pretendimin për mosgjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm*

7. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*sib vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim kërkuari pretendon se pas ushtrimit të ankimit nga subjekti i interesuar Lufti Hasani ndaj vendimit nr. 12508, datë 18.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka pranuar hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k., kryesekretaria e kësaj të fundit ka dërguar në Gjykatën e Apelit dosjen origjinale, fakt që e ka penguar atë në ekzekutimin e vendimit të



shkallës së parë, i cili sipas nenit 7/1 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin” është menjëherë i ekzekutueshëm. Gjithashtu, sipas kërkesit, gjykimi në Gjykatën e Apelit nuk është zhvilluar brenda afatit 30-ditor, rrethanë që edhe kjo ka ndikuar në bllokimin e procedurave të falimentimit.

9. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ka theksuar se vlerësimi duhet të kryhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke ju referuar sidomos kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkesit, sjelljes së autoriteteve, si dhe rrezikut që passjell për kërkesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (shih *vendimin nr. 1, datë 21.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të analizohet secili prej elementeve të sipërcituara.

i) Periudha që dubet marrë në konsideratë

10. Lidhur me pretendimin për zgjatjen e procesit në Gjykatën e Apelit Tiranë tej afatit të arsyeshëm, nga materialet e administruara Gjykata vëren se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Apelit në vitin 2012 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 29.4.2014, ndonëse neni 7/6 i ligjit nr. 8901/2002 parashikon afatin prej 30-ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo Gjykatë, pra jashtë afatit ligjor të lartpërmendur.

ii) Kompleksiteti i çështjes

11. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (shih *vendimet nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi lidhet me procedurat e falimentimit të shoqërive, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 8901/2002. Nga shqyrtimi i dokumenteve të

paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkesit

13. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

14. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme*”. Gjithashtu, neni 171/a të KPC-së përcakton se “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*” (shih *vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre, Gjykata vëren se disa nene të ligjit nr. 8901/2002 të lartpërmendur², ndër parimet e gjykimit të çështjeve që lidhen me procedurat e falimentimit, kanë përcaktuar edhe garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të

² Shih nenet 3, 7, 18 të ligjit nr. 8901/2002.



shpejta dhe të arsyeshme (afat 30-ditor si në gjykimin në shkallë të parë, ashtu edhe në atë në apel), me qëllim shlyerjen e detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjen e të ardhurave.

16. Gjithashtu, Gjykata në lidhje me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është shprehur se kur ligjvënësi ka përcaktuar afate kohore, do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Po në këtë këndvështrim Gjykata në çështje të ngjashme ka vlerësuar se justifikimet se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, siç parashikohet në nenin 7/6 të ligjit nr. 8901/2002, është i bazuar.

B. Për pretendimin për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror

18. Gjykata çmon se kërkuari nuk legjitimohet në këtë kërkim, pasi nuk është në kompetencë të Gjykatës të shqyrtojë dhe të vlerësojë dëmin pasuror e jopasuror të shkaktuar për arsye që lidhen me moszbatimin e një vendimi gjyqësor. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të

dispozitave të Kodit Civil, që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (*neni 450 i Kodit Civil*). Vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike që parashikon ligji, kërkuari mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja "P", të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit të arsyeshëm të parashikuar nga neni 7/6 i ligjit nr. 8901/2002.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 73/4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Vladimir Kristo

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë